



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURIYETI
Komuna e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 12/23 Dt. 13.01.2023



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No.	54/23
Datë: Datum: Date:	10.01.23
PRISHTINË / A No. 1	

swisscontact

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

NË MES

MINISTRISË SË MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE
INFRASTRUKTURËS

KOMUNËS SË PRIZRENIT

DHE

SWISSCONTACT - PROJEKTI "PROMOVIMI I PUNËSIMIT NË
SEKTORIN PRIVAT"

PËR

REALIZIMIN E PROJEKTIT TË NDËRTIMIT TË TELEFERIKUT NË
KALANË E PRIZRENIT

Janar, 2023

Në mbështetje të nenit 10 dhe 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 Mars, 2019), nenit 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 1 pika 10 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (Gazeta Zyrtare, Nr. 28/04 Qershor 2008), Kodit projektit nr.15427 të paraparë në Ligjin Nr. 08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023 (Gazeta Zyrtare, 38/2022, 30.12.2022), si dhe nenit 7 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim, palët e këtij Memorandumi të Mirëkuptimit:

1. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, të cilën e përfaqëson Ministri Liburn Aliu, në tekstin vijues "MMPHI",
2. Komuna Prizrenit, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Shaqir Totaj, në tekstin vijues "Komuna" dhe
3. SWISSCONTACT, të cilën e përfaqëson Menaxheri i Projektit "Promovimi i punësimit në sektorin privat" financiar nga Qeveria Zvicerane, Fisnik Recica, në tekstin vijues "PPSE"

lidhin:

**MEMORANDUM TË MIRËKUPTIMIT PËR
REALIZIMIN E PROJEKTIT TË NDËRTIMIT TË TELEFERIKUT NË KALANË E
PRIZRENIT**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i këtij Memorandumi të Mirëkuptimit në tekstin në vijim "Memorandumi" është të krijojë lidhje bashkëpunimi në mes MMPHI-së, Komunës së Prizrenit dhe PPSE-së për realizimin e projektit "Ndërtimi i teleferikut në Kalanë e Prizrenit".

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Palët pajtohen që të bashkëpunojnë në zhvillimin e projektit "Ndërtimi i teleferikut në Kalanë e Prizrenit" me qëllim të zhvillimit të sektorit të turizmit në Prizren duke u zotuar se do të angazhohen që të kontribuojnë sipas kompetencave që kanë për realizimin e këtij projekti.

**Neni 3
Përgjegjësitë e palëve**

1. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, secila prej palëve zotohet t'i zbatojë përgjegjësitë e mëposhtme, me qëllim të realizimit sa më të mirë dhe efikas të qëllimit të këtij Memorandumi.
2. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Mjedisit do të angazhohet për:

2.1. Bashkëpunim të ngushtë me kompaninë që do të ofroj ekspertizën në përpilimin e studimit të fizibilitetit gjatë procesit të raportit gjeoteknik.

2.2. Përkrahjen financiare për përpilimin e studimit të fizibilitetit e cila do të mbuloj koston prej 50% të koston totale të ekspertizës teknike në përpilimin e studimit të fizibilitetit menaxherial për operimin e teleferikut në Kalanë e Prizrenit.

2.3. Ta siguroj buxhetin për ndërtimin e teleferikut.

3. Komuna e Prizrenit do të angazhohet për:

3.1. Bashkëpunimin me projektin PPSE dhe MMMPHI-në për realizimin e projektit të ndërtimit të teleferikut në Kalanë e Prizrenit.

3.2. Marrjen e lejeve dhe pëlqimeve sipas ligjeve përkatëse (Ligjin për Planifikim Hapësinor, Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Ligjin për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe Ligjin për Ndërtim, Ligjit për Trashëgiminë Kulturore, Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit) si dhe akteve tjera nënligjore.

3.3. Bashkëpunimin me Ministrinë dhe kompaninë gjeodezike për raportin gjeoteknik.

3.4. Bashkëpunimin me projektin PPSE dhe kompaninë e cila do të ofroj ekspertizën në përpilimin e studimit të fizibilitetit, si dhe në dhënien e informatave.

3.5. Bashkëpunimin me projektin PPSE në përpilimin e tenderit për ndërtimin e teleferikut.

4. Swisscontact do të angazhohet për:

4.1. Ofron përkrahje me ekspertizë teknike në përpilimin e studimit të fizibilitetit menaxherial për operimin e teleferikut në Kalanë e Prizrenit.

4.2. Mbulon 50% të koston totale të ekspertizës teknike në përpilimin e studimit të fizibilitetit menaxherial për operimin e teleferikut në Kalanë e Prizrenit.

4.3. Merr përsipër procedurat e prokurimit në përzgjedhjen dhe angazhimin e kompanisë, e cila do ta përpiloj studimin e fizibilitetit menaxherial për operimin e teleferikut në Kalanë e Prizrenit.

4.4. Siguron koordinimin në mes të kompanisë që do të angazhohet për përpilimin e studimit të fizibilitetit, Komunës së Prizrenit dhe MMPHI.

4.5. Ofron përkrahje në përpilimin e tenderit për ndërtimin e teleferikut.

Neni 4
Koordinimi dhe Konsultimet

1. Palët pajtohen që gjatë implementimit të këtij memorandum , do të shkëmbejnë informacione dhe do të takohen rregullisht të paktën një (1) here në muaj për të vlerësuar dinamikat e zbatimit të memorandumit.
2. Palët do të përfaqësohen nga personat e caktuar nga nënshkruesit e Memorandumit.

Neni 5
Ndryshimet dhe ndërprerja e Memorandumit të Mirëkuptimit

1. Me pëlqimin paraprak të palëve Memorandumi mund të ndryshohet dhe plotësohet.
2. Palët mbajnë të drejtën e ndërprerjes të njëanshme të Memorandumi duke njoftuar me shkrim tridhjetë (30) ditë më herët palën tjetër, në rast se konstatojnë se palët nuk i kanë përmbushur përgjegjësit e veta të dala nga ky Memorandum.

Neni 6
Zgjidhja e kontesteve

1. Palët veprojnë në besueshmëri të plotë për të siguruar arritjen e të gjitha objektivave të memorandumit.
2. Mospajtimet ose interpretimet eventuale të ndryshme të pikave të këtij memorandum, do të zgjidhen me mirëkuptim dhe marrëveshje konsensuale.

Neni 7
Hyrja në fuqi

1. Ky Memorandum hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve nënshkruese dhe do të zgjasë deri më 15 Nëntor 2025.
2. Nënshkruar në Prishtinë me datë 10.01.2023 në tri (3) kopje, nga një (1) kopje për secilën palë nënshkruese.

Liburn Aliu, Ministër
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Shaqir Totaj,
Kryetar i Komunës së Prizrenit

Fisnik Reçica,
Menaxher i Projektit, PPSE - Swisscontact